



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/28;
Datë: 14.10.2020 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 29.09.2020 nxjerrë:

V E N D I M

për

plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

- I. Me këtë vendim plotësohet vendi bosh në Komitetin për Politikë dhe Financa.
- II. Anëtari i zgjedhur për t'iu bashkuar Komitetit për Politikë dhe Financa është z. Florim Shala .
- III. Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i këtij anëtari janë të njëjta me detyrat, përgjegjësitë dhe mandatin e anëtarëve të tjerë të Komitetit për Politikë dhe Financa.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të K.K. në Komunën e Junikut.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. z. Florim Shala;
2. Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Kryetari i Komunës së Junikut;
4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
5. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
6. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Muharrem Krasniqi

kryesues

